



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:041222  
Datë: 28.03.2024  
Numri i dokumentit: 05520386

**Ac.nr.6166/2023**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Naime Ahmeti kryetare e kolegjit, Burim Shala dhe Besnik Feka, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.O., nga Gjakova, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Y.B., avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson e autorizuar V.Sh., me objekt kontesti kompensimi i shpërblimit jubilar, duke vendosur sipas ankesës së përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.187/2022, të datës 23.07.2023, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 28.03.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** e pa themeltë ankesa e paditësit B.O., nga Gjakova, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.187/2022, i datës 23.07.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me Aktgjykimin e atakuar ka vendosur si vijon:

*“I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit B.O., nga Komuna e Gjakovës, përmes së cilës ka kërkuar që të “detyrohet e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, që paditësit të lartcekur, në emër të shpërblimit jubilar për 32 vite përvojë pune, të ia paguajë shumën prej 528.20 € (pesëqind e njëzet e tetë euro e njëzet cent), me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të filloi të llogaritet nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet procedurale”*

## *II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.’’*

Kundër këtij aktgjykimi paditësi përmes të autorizuarit të tij në afatin e paraparë ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit duke e aprovuar ankesën e të paditurës si të bazuar, ta ndryshoj aktgjykimin e atakuar ashtu që kërkesëpadinë e paditësit ta aprovoj si të bazuar dhe ztë detyroj të paditurën që paditësit t'i paguaj edhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

### **- Ankesa është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi, përmes të autorizuarit të tij, kanë ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – DKA, me të cilën ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadija e paditësit dhe të detyrohet e paditura, që paditësit për 32 vite përvojë pune në emër të shpërblimeve jubilarë t'ia paguaj shumën prej 528.20 €, me kamatë si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Nga ana tjetër e paditura, përmes përgjigjes në padi, e ka kontestuar në tërësi si të pa bazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, duke propozuar që të njëjtën ta refuzoj si të pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas pranimi të përgjigjes në padi nga e paditura, si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, e në pajtim me nenin 399 të LPK-së, ka nxjerrë aktgjykim e atakuar, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimin e atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 dhe paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat janë pretenduar nga pala ankuese.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësit për gjendjen faktike të vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, për arsye se sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë gjendjen faktike, ku edhe janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e tillë të vendosjes sipas aktgjykimit të ankimuar, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, me çka drejtë ka ardhur edhe gjer te aplikimi i të drejtës materiale.

Gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë, pasi që nuk ishte kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune te e paditura në Gjimnazin ‘‘H..... D.....’’ në Gjakovë, nga data 01.09.1984, fakt i vërtetuar me vërtetimin e datës 27.01.2023 i lëshuar nga e paditura dhe se i njëjti kishte 36 vite përvojë pune te e paditura, mirëpo kërkesëpadia e paditësit, për të kërkuar shpërblimin jubilar ashtu siç përcaktohet me nenin 35 paragrafin 8, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, është e parashkruar, duke pas parasysh faktin se paditësi padinë e ka ushtruar me datë 21.02.2022, ndërsa e drejta për shpërblim jubilar ka rrjedhë nga data 18.04.2017, ndërsa paditësi jubileun e 30 e ka arritur në vitin 2017, andaj Kolegji i gjykatës së shkallës së dytë, ka gjetur se gjykata e shkallës së parë drejt ka konstatuar se në rastin konkret kërkesa e paditësit është e parashkruar konform nenit 87 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, me të cilin është e përcaktuar se të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës parashkruhen brenda afatit prej tri vitesh nga dita e paraqitjes së kërkesës.

Rrjedhimisht të drejtë kjo gjykatë e vlerëson përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë kur e njëjta me rastin e vendosjes sipas aktgjykimit të ankimuar ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është pa bazuar, duke qenë se shpërblimi jubilar në rastin konkret nuk ka bazë juridike për shkak të parashkrimit.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat pretendime nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura më lart e në pajtim me dispozitën e nenit 194, 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.6166/2023, me datë 28.03.2024**

**Kryetare e Kolegjit**  
**Naime Ahmeti, d.v**